**KËRKESË**
**Nr. 1984/8, datë 18.11.2019**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i varrezave publike, faza e pestë, njësia administrative Portëz, fshati Mbyet", Fier.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 1, 863, 363 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**Artan Shkreli**

**Lista paraprake e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i varrezave publike, faza e pestë, Njësia Administrative Portëz, fshati Mbyet", Fier**

Vlerësimi për pasurinë tokë arë, është bërë sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016

| Nr. | Emër, mbiemër | Zona kadastrale | Nr./pasurisë | Sipërfaqja e përgjithshme, tokë bujqësore/$m^2$ | Sipërfaqja që preket tokë bujqësore/$m^2$ | Çmimi Tokë bujqësore/ $m^2$ | Vlera e tokës bujqësore/ lekë | Vlera totale/lekë | Konfirmuar nga ASHK |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Elca Myzafer Hoxhaj | 2637 | 288/126 | 1500 | 1500 | 269 | 403,500 | 403,500 | Certifikatë pronësie |
| 2 | Selvi Xhafa (Hoxhaj) Hasmen Hoxhaj, Lavdie Llanaj, Behije Qose, Xhevaire Shehaj, Sare Meta, Ramazan Hoxhaj, Merita Sadushi, Kozeta Kalemi | 2637 | 288/89 | 5427 | 5427 | 269 | 1,459,863 | 1,459,863 | Certifikatë pronësie |
| **Vlera totale e shpronësimit** | | | | **6927** | **6927** | | | **1,863,363** | |